

“Interpretation/translation in virtual reality. Curricula-Design READ-PROJECT

Prof.Dr. Bardhyl Demiraj

Prof.as.dr. Ema KRISTO



Hyrje

- Përkthimi është një prej fushave me kërkesë në rritje; si në institucionet publike ashtu edhe private ka nevojë për përkthyes të kualifikuar, të cilët paraqesin një profil të mirëformuar nga ana profesionale.
- Gjuhët e huaja po luajnë një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin midis kombeve të ndryshme anë e mbanë botës. Përdoren në shumë takime ndërkombëtare, qofshin ato politike, ekonomike, sociale, artistike, letrare, etj.
- Ndërveprimi diplomatik dhe politik midis kombeve është duke u rritur gjithnjë e më shumë, duke rritur, për rrjedhojë, edhe kërkesën për profesionalizëm në përkthim. Ligjet ndërkombëtare duhet të përkthehen saktësisht me qëllim që t'i përshtatet mentalitetit kombëtar, kulturor dhe politik të vendit të gjuhës së përkthimit.

Hyrje

- Bashkimi Evropian dhe Komisioni Evropian po i japin përkthimit një rëndësi të vecantë me programe dhe fonde të posaçme, në të cilat për fat të mirë merr pjesë edhe Shqipëria, si vend kandidat për hyrjen në EU.
- Historikisht interpretimi/ përkthimi ka qenë një “mundësues” komunikimi, duke mundësuar që njerëzit me gjuhë dhe kultura të ndryshme të komunikojnë. Por deri vonë, përkthyesit/ interpretuesit mundësonin komunikimin në situata të përbashkëta si takime dhe konferenca. Sot shoqëritë kanë fituar gjithnjë e më shumë akses në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, kërkesa për ofrimin e shërbimeve në distancë, të shpejta dhe të menjëhershme po bëhen gjithnjë e më të domosdoshme, vlerësuar edhe në kontekstin e pandemisë.

Hyrje

- Meqenëse shumica e shoqërive po bëhen gjithnjë shumëgjuhësore dhe multikulturore, shërbimet gjuhësore virtuale po marrin një vlerë të veçantë. Përkthimi në distancë ofron një mundësi të shkëlqyer për kompanitë, institucionet dhe organizatat, të cilat kanë nevojë gjithnjë e në rritje për përkthyes, pasi nëpërmjet tij mund të rekrutohen përkthyes pothuajse kudo dhe për çdo gjuhë.
- Bashkimi Evropian rekomandon përkthimin në distancë edhe në procedurat ligjore kur ndërmjetësimi gjuhësor është thelbësor për të garantuar të drejtat themelore të qytetarëve (Direktiva 64/2010).

Argumentimi

- Në fushën e shërbimeve të konferencave ka një rritje të shpejtë të platformave të përkthimit online. Përkthimi në distancë po bëhet gjithnjë e më popullor në shumë industri dhe përdoret çdo ditë për komunikim të menjëhershëm dhe në kohë reale. Ai ofron disa përparësi edhe për përkthyesit; mundësinë për të punuar nga shtëpia, madje edhe nga vende të largëta, dhe për të shmangur udhëtime në distanca të gjata.
- Komunikimi në distancë (nëpërmjet telefonit dhe videokonferencës) ndryshon nga ndërveprimi ballë për ballë në shumë aspekte. Para së gjithash, ekziston një mungesë e "prezencës" sociale në ndërveprimet në distancë, gjë që e bën ndërtimin e raportit më të vështirë për folësit në krahasim me ndërveprimet ballë për ballë.

Qëllimi dhe objektivat

- Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i strategjive për kurrikula të reja mësimore për trajnimin në interpretimin/ përkthimin në distancë për studentët që vazhdojnë studimet masterit përmes bashkëpunimit me universitete të tjera, veçanërisht me diasporën (Universiteti i Mynihut, Programet e reja të përkthimit, degë e re) që ofrojnë programe interpretimi dhe ofrues të shërbimit të përkthimit në distancë, duke zhvilluar një mjedis mësimor virtual dhe materiale mësimore për studentët-përkthyes si dhe *ridizenjim të kurrikulës së përkthimit duke e bërë atë me interesante për studentët, duke çuar edhe në rritjen e numrit të studentëve në këtë program studimi.*
- Këto materiale mësimore do të ofrojnë një kornizë teorike si dhe këshilla praktike për studentët përkthyes. Sfondi teorik është i nevojshëm për të kuptuar mekanizmat dhe veçoritë specifike të interpretimit në distancë (si telefonik ashtu edhe videokonferenca) me fokus në veçoritë themelore të komunikimit të interpretuar në distancë, mbi implikimet sociale, pragmatike dhe etike, mbi mjediset dhe fushat lëndore në të cilat përdoret më së shumti interpretimi në distancë dhe mbi palët, faktorët dhe instrumentet e përfshira.

Qëllimi dhe objektivat

- Projekti synon gjithashtu të adresojë nevojën për të zbatuar interpretimin/ përkthimin virtual si një nga format më të preferuara në shoqërinë e sotme si dhe trajnimin dhe aftësimin e studentëve për përkthim në gjuhë të huaja duke përfshirë një analizë të studimeve në fushën e përkthimit, koordinim ndërmjet programeve ekzistuese me synimin që të sugjerojmë modele të reja për aftësimin e studentëve për përkthimin virtual.

Çfarë e motivoi këtë projekt

- hulumtimi i përvojës botërore në lidhje me përkthimin virtual, llojet dhe rëndësinë e tij në përgatitjen e qytetarëve të ardhshëm të një bote dixhitale;
- mbështetja në përvojën pozitive të diasporës
- nevoja e kualifikimit të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar (IAL) në metodologjitë moderne pedagogjike dhe didaktike të përkthimit virtual.
- mbështetjen e IAL-ve shqiptare në përshtatjen dhe zbatimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikutimit (TIK) në mësimdhënie dhe integrimin e IAL-ve shqiptare në një rrjet global për "Mobilitetin Virtual".
- Kërkesat për ndërthurjen e mësimdhënies në auditor me përkthimin virtual, si element i Lëvizshmërisë Virtuale, duke përfshirë perspektivat ndërkombëtare në programet e studimit, në një qasje holistike ndaj ndërkombëtarizimit të institucioneve shqiptare.

Produkti/ produktet e projektit

- Produkti përfundimtar i projektit është ridizenjimi i duke përfshirë përkthimin në distancë
- Hartimi dhe publikimi i manualeve dhe materialeve të reja mësimore në bashkëpunim me diasporën dhe programe të ngjashme
- Hartimi i materialeve didaktikë

METHODOLOGJI

- Metodologjia e përdorur në realizimin e këtij punimi:
- Shqyrtime të dokumenteve të botuara dhe kërkime mbi situatën e përkthyesve.
- Intervistat dhe anketat me pedagogë dhe studentë. Ky projekt është hartuar në formën e një kërkimi të strukturuar dhe të organizuar i cili konsiston në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore.
- Analizë e modeleve të zhvillimit profesional të përkthyesve në diasporë për të identifikuar modelet më të suksesshme që mund të përdoren ose përshtaten në Shqipëri.

ACTIVITETE

- **Aktiviteti: Prezantimi i projektit me të gjithë studentët e nivelit master të përkthimit**
- **Përpilimi i pyetjeve janë dhe plotësimi i saj nga nxënësit. Ky aktivitet do të jetë hapi i parë i zbatimit të projektit**
- **Aktiviteti: Përpunimi i të dhënave. Ky aktivitet synon të arrijë përpunimin e të dhënave të krijuara nga plotësimi i pyetësorëve në lidhje me temën e projektit**
- **Aktiviteti : Hartimi i materialeve të trajnimit.**
- **Aktiviteti: Botimi i manualeve didaktike.**

Resultate

- Në përfundim të këtij projekti, studentët e nivelit Master në përkthim do të mund të prezantohen dhe do të kenë përmirësuar disa nga teknikat praktike të përkthimit online.
- Hartimi i një raporti përfundimtar do të mbetet si një dokument i rëndësishëm në hartimin e kurrikulave të programeve të reja në të ardhmen. Së fundi, rezultatet e këtij projekti përbëjnë një hap të rëndësishëm në përdorimin e metodave bashkëkohore në fushën e përkthimit.

Kohezigjatatja

1 vit

